

Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; Ligji Nr. 05/L-038, neni 14, 15 dhe 16, dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 29, 30, 31, 33, 34 dhe 35, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 16 mars 2017, nxori këtë

RREGULLORE
PËR PROPOZIMIN DHE ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KRYESISË
SË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Neni 1

1. Rregullorja përcakton ecurinë e propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Neni 2

1. Kryesinë e Akademisë e përbëjnë Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë.
2. Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katër vjeçare (4) me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Neni 3

1. Kryetari i Akademisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt të Akademisë.
2. Nënkryetari i Akademisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt të Akademisë.
3. Sekretari shkencor i Akademisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt ose të anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
4. Sekretari i seksionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt ose anëtarëve korrespondentë të Akademisë.

Neni 4

1. Anëtarët e Akademisë mbi moshën shtatëdhjetë e pesë (75) vjeçare nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse (Kryetar, Nënkryetar, Sekretar shkencor dhe Sekretar i seksionit):
 - 1.1. Anëtarëve të Akademisë që ushtrojnë funksione udhëheqëse ditën që mbushin moshën 75 vjeç u ndërpritet ushtrimi i funksionit udhëheqës;
 - 1.2. Procedura e zëvendësimit të anëtarëve të Akademisë në funksione udhëheqëse nis tre muaj para mbarimit të mandatit në këto funksione; dhe
 - 1.3. Anëtarët e Akademisë që zgjidhen në vende udhëheqëse nëpërmjet procedurës së zëvendësimit, sipas nënparagrafit 1.1 të këtij neni, ushtrojnë mandatin e mbetur deri në zgjedhjet e reja sipas nënparagrafit 1.2 të këtij neni.

Neni 5

1. Anëtarët e Akademisë që ushtrojnë funksione politike dhe shtetërore nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse në Akademi.
 - 1.1. Funksione politike dhe shtetërore konsiderohen: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, Ministri, Zëvendësministri, Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Kryetari i Komunës dhe Kryetari i partisë.

Neni 6

1. Kryesia e Akademisë thërret seancën zgjedhore të Kuvendit, së paku tridhjetë ditë përpara, dhe cakton mbledhjen I dhe II të seksioneve.

Neni 7

1. Seksionet e Akademisë me vota të fshehta zgjedhin nga radhët e veta Sekretarin e seksionit.
 - 1.1. Për kandidatët për Sekretar seksioni votohet me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas alfabetit.
2. Për funksionin Sekretar i seksionit konsiderohet i zgjedhur kandidati që fiton shumicën e votave të anëtarëve të seksionit.
3. Nëse për funksionin Sekretar i seksionit asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave, votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.
 - 3.1. Në votimin e përsëritur për kandidatët për Sekretar seksioni votohet me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas numrit të votave.

Neni 8

1. Anëtarët e seksionit në mbledhjet I me vota të fshehta propozojnë nga një kandidat për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor.
 - 1.1. Kandidatët për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor votohen me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas alfabetit.
2. Për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor konsiderohet i propozuar kandidati që fiton shumicën e votave të anëtarëve të seksionit.
3. Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave, votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.
 - 3.1. Në votimin e përsëritur për kandidatët për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor votohet me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas numrit të votave.
4. Në qoftë se kandidati përsëri nuk fiton mbi gjysmën e votave të anëtarëve të seksionit, konsiderohet se seksioni nuk ka kandidat të vetin për funksionin e caktuar në Kryesinë e Akademisë.



Neni 9

1. Seksionet e Akademisë ia dërgojnë Kryesisë së Akademisë emrat e kandidatëve të propozuar për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor, dhe e njoftojnë për zgjedhjen e Sekretarit të seksionit.
2. Kryesia e Akademisë ua kthen seksioneve për votim përfundimtar, të gjithë kandidatët e propozuar nëpër seksione për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor.

Neni 10

1. Anëtarët e seksionit në mbledhjet II votojnë me vota të fshehta nga një kandidat nga listat e përbashkëta të të propozuarve për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor të Akademisë.
 - 3.1. Kandidatët për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor votohen me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas alfabetit.
2. Për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor konsiderohet i propozuar kandidati që fiton shumicën e votave të anëtarëve të seksionit.
3. Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave, votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.
 - 3.1. Në votimin e përsëritur për kandidatët për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor votohet me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas numrit të votave.
4. Në qoftë se kandidati përsëri nuk fiton mbi gjysmën e votave të anëtarëve të seksionit, konsiderohet se seksioni nuk ka kandidat të vetin për funksionin e caktuar në Kryesinë e Akademisë.

Neni 11

1. Propozimet përfundimtare të seksioneve për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor, dhe njoftimi për zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve u shpërndahen anëtarëve të Akademisë së paku 15 ditë para mbajtjes së seancës zgjedhore të Kuvendit të Akademisë.

Neni 12

1. Kuvendi i Akademisë zgjedh Kryetarin, Nënkyetarin dhe Sekretarin shkencor të Akademisë nga radhët e kandidatëve të propozuar nga seksionet.
 - 1.1. Kandidatët për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor votohen me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas alfabetit.
2. Kandidatë të zgjedhur konsiderohen ata që kanë fituar shumicën e votave të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
3. Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave, votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.
 - 3.1. Në votimin e përsëritur për kandidatët për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor votohet me fletëvotime në të cilat kandidatët renditen sipas numrit të votave.



4. Në rast të dështimit të zgjedhjes së njërit ose të të gjithë kandidatëve për funksionet e caktuara, Kryesia thërret seancën zgjedhore sipas afateve të përcaktuara në statut dhe vazhdon punën deri në zgjedhjen e Kryesisë së re.

Neni 13

1. Kuvendi i Akademisë miraton në parim zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve.

Neni 14

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nxjerr më 4 korrik 2006 nga Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Neni 15

1. Rregullorja hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.



KRYETARI I AKADEMISË

Akademik Hivzi Islami